


MONITORIM

Arsimi & Premtimet

NJË VIT NGA PREMTIMET PËR ARSIMIN
KATËR VITE NGA PAKTI PËR UNIVERSITETIN
STUDENTËT DHE KRYEQYTETI



404
Page not found



KONTEKSTI

METODOLOGJIA

1. NJË VIT NGA PREMTIMET PËR ARSIMIN

- 1.1 *Kampuset universitare*
- 1.2 *Universitetet*
- 1.3 *Shkollat*

2. KATËR VITE NGA PAKTI PËR UNIVERSITETIN

- 2.1 *Portali i transparences*
- 2.2 *Vetingu akademik*
- 2.3 *Sondazhi kombetar i studenteve*
- 2.4 *Pune te mbare.al*
- 2.5 *Biblioteka digjitale*

3. STUDENTËT DHE KRYEQYTETI

- 3.1 *Gjendja ekzistuese*
- 3.2 *Ndihma e shtetit përballë shpenziemve të studentëve*
- 3.3 *Karta e studentit si mundësi për transport publik falas*


GJETJET KRYESORE

REKOMANDIME












Ky botim u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projektit "Arsimi në Fokus", me mbështetjen financiare të Olof Palme Center. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

KONTEKSTI

Qeveria shqiptare mbushi vitin e parë të mandatit të tretë nën drejtimin e Partisë Socialiste. Në kabinetin “Rama 3” pati ndryshime të vogla strukturore, rokada ministrash ekzistues dhe pak emra të rinj në postin e ministrit. Në krye të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit qëndroi përsëri Evis Kushi, e cila zvendësoi Besa Shahinin në 15 shtator të vitit 2020.



Gjatë fushatës zgjedhore të 25 prillit Qëndresa Qytetare monitoroi premtimet zgjedhore të partive politike të lidhura me arsimin. Partia Socialiste nuk pati program politik të shkruar dhe i vetmi material i referueshëm ishte një video e kryeministrit Rama ku fliste për vizionin e Partisë Socialiste për arsimin, në të cilën identifikohen 11 premtime.¹ Këto premtime nuk u shoqëruan me afate, buxhet, terma konkrete dhe dokumenta të shkruar, e për rrjedhojë monitorimi i tyre në vitin e parë të qeverisjes mbetet një sfidë e madhe për këdo që kërkon të ushtrojë presion apo kërkojë llogari qeverisë për arsimin.

1	 O shkolle me 2 turne	7	 Hapja e Programit 10 vjeçar të kodimit në botën digjitale për fëmijët 12 deri në 18 vjeç. Qendra e parë do të jetë tek Piramida dhe të tjerat në secilin prej qendrave urbane.
2	 Mbyllja e klasave kolektive nëpërmjet krijimit të modelit arsimor digjital	8	 Hapja e Programit Kombëtar të arteve dhe zejeve ku të rinjtë të mësojnë profesionet.
3	 Ndërtimi i kampusit të ri universitar në Qytetin Studenti me sipërfaqe 28 000 m ²	9	 Deri në vitin 2025 të gjithë drejtorët e shkollave do të llogosen nga Shkolla e Drejtorëve për të drejtuar shkollat edhe si Qendra Komunitare.
4	 Përfundimi i kampusit universitar të Universitetit Bujqësor të Tiranës, kampusit të Arteve, dhe atij të Politeknikut.	10	 Universitete të sipikatura ndërkombëtare do të jenë të integruara në arsimin tonë publik. Universiteti Teknik i Stambollit do të jetë dallëndyshja e parë e këtij projekti.
5	 Rritja e pagave të mësuesve në masën 40%	11	 Vendosim në dispozicion të universiteteve shqiptare 10 milion euro në vit për të hapur programe të përbashkëta me universitetet e Bashkimit Europian në shkenca teknike.
6	 Gjuha angleze do të mësohet në të gjitha shkollat e vendit që në klasën e parë		

Një tjetër element i evidentuar nga premtimet që lidheshin me arsimin parauniversitar ishte përsëritja e premtimeve të bëra gjatë fushatës së vitit 2013 dhe 2017, c'ka faktin edhe mosmbajtjen e disa prej tyre gjatë qeverisjes në 8 vite. Premtimet e përsëritura ishin, dhënia fund e mësimin me turne,

kthimi dhe përshtatja e shkollave në qendra komunitare dhe digjitalizimi i procesit mësimor në shkollat e vendit.

¹ <https://top-channel.tv/2021/03/16/pagat-e-mesuesve-do-rriten-40-plani-per-arsimin-rama-ps-e-cliroi-nga-kthetrat-e-politizimit/>

Pavarësisht se gjatë fushatës zgjedhore kryeministri Rama e cilësoi si të suksesshme reformën në arsimin e lartë, ai vetëm pak muaj më vonë, në datën 10 shtator 2021 gjatë takimit me Bordin e ri të Akreditimit u shpreh për herë të parë pas 6 vitesh se ligji 80/2015 nuk është perfekt dhe mund të ndryshojë.² Gjithashtu gjatë këtij takimi ai pranoi se cilësia e ofrimit të arsimit në vend ka probleme dhe duhet punuar në këtë drejtim. Po ashtu në 26 maj 2022 qeveria Rama u tërhoq nga një tjetër politikë të cilën e shiti të suksesshme,

sic ishte rritja e mesatares në masën 7.5 për degët e bachelorit që kanë akses në mësuesi, si historia, gjuhët e huaja, biologjia apo matematika, duke penalizuar mijra nxënës dhe mbyllur dhjetra degë në të gjithë Shqipërinë.

Qëndresa Qytetare përgatiti një axhendë për arsim cilësor dhe mbështetjen e të rinjve të cilën ua vendosi në dispozicion partive politike gjatë fushatës zgjedhore prill 2021. Pavarësisht

ngurtësisë së treguar nga partitë për një pjesë të sugjerimeve të cilat lidheshin me cilësinë e arsimit, në aspektin elektoral dhe buxhetor partitë e mbështetën këtë dokument politikash. Një nga sugjerimet e axhendës ishte shtimi i numrit të psikologëve në shkolla, nga 1 psikolog në 3 shkolla në të paktën 1 psikolog për shkollë. Në atë kohë për këtë rekomandim Partia Socialiste nuk shprehu

interes në muajin prill, por Ministrja Evis Kushi në datën 29 tetor nxorri urdhrin për ristikurimin e psikologëve në shkolla duke dyfishuar numrin e tyre, si rezultat edhe i ngjarjeve tragjike të njëpasnjëshme të ndodhura në shkollat e vendit.³Vitit 2022 daton të katërtin vit të zbatimit të zotimeve të Paktit për Universitetin dhe për shkak të rëndësisë, energjisë dhe akteve ligjore që prodhoi ai dokument politikash në këtë material do të bëjmë një rivlerësim të politikave të ndërmarra në 4 vite,

ecurinë, qëndrueshmërinë dhe efektin e tyre.⁴ Në fokus të këtij studimi do të jetë edhe situatë financiare dhe ekonomike e studentëve të cilët vijnë pas pandemisë në dyert e auditoreve me cmime të rritura, krizë socio – ekonomike dhe sfida të akomodimit, ushqimit apo transportit.



² <https://ata.gov.al/2021/09/10/cilesia-e-arsimit-te-larte-rama-me-bordin-e-akreditimit-sfida-jone-tu-japim-te-rinje-alternative/>

³ <http://ata.gov.al/2020/10/29/sherbimi-psiko-social-ministrja-kushi-dyfishimi-i-numrit-te-punonjesve-vjen-si-pergjigje-e-nevojave-ne-shkollat-tona/>


⁴ <https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2019/01/PAKTI-P%C3%8BR-UNIVERSITETIN.pdf>

METODOLOGJIA

Për të analizuar vitin e parë të qeverisjes lidhur me arsimin janë marrë në shqyrtim dhe analizë të gjitha premtimet e bëra gjatë fushatës së zgjedhjeve të 25 prillit duke bërë fact-checking nëpërmjet deklaratave, akteve të ndërmarra, mediave investigative dhe kërkesave për informacion drejtuar institucioneve përgjegjëse.

Në shqyrtim gjithashtu është marrë buxheti i shtetit i miratuar nga parlamenti dhe strategjia e re për arsimin 2021 – 2026. Përveç analizës së ecurisë së qeverisjes në 100 ditë lidhur me premtimet e bëra nga Partia Socialiste, ekipi i Qëndresës Qytetare, nisur edhe nga ankesat e mbërritura nga studentët, ka vlerësuar të nevojshme të realizojë edhe një analizë të situatës financiare të studentëve në fillim të vitit akademik 2021 – 2022, periudhë e cila përkon edhe me vitin e parë të qeverisjes Rama 3.

Për ta shtrirë në kohë analizën janë marrë në shqyrtim zotimet e qeverisë në kuadër të Paktit për Universitetin në terma politikash, afatesh, efektesh dhe përfitimesh për kategoritë e studentëve.



1 NJË VIT NGA PREMTIMET PËR ARSIMIN?

Më 25 nëntor 2021 u miratua buxheti i shtetit për vitin 2022 me vota të mazhorancës. Pavarësisht se Ministrja e Arsimit u shpreh se ky është buxheti më i madh në histori, shifrat qëndrojnë ende larg premtimit të vitit 2013, për rritjen në masën 5% të GDP.⁵

Nëse e shohim në planin krahasimor me buxhetin e vitit 2021, buxheti për arsimin është rritur me 28 milion euro në vitin 2022. Kryesisht është rritur buxheti për arsimin bazë me rreth 16 milion euro, buxheti për arsimin e mesëm me 5 milion euro, fondet për arsimin universitar janë rritur me 7.5 milion euro dhe fondet për shkencë u rritën vetëm me 550 000 euro krahasuar me vitin 2021. Ndërkohë buxheti për zhvillimin e sportit dhe rinisë është reduktuar me rreth 2.5 milion euro krahasuar me vitin 2021, pavarësisht se u krijua një ministri e dedikuar për rininë si edhe Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Në fokus të premtimeve të bëra në fushatën e zgjedhjeve të 25 prillit ishte ndërtimi i kampuseve universitare, godinave akomoduese, digjitalizimi i shkollave dhe rritja e pagave për mësuesit. Gjatë këtij viti u miratua me V.K.M Nr.621, datë 22.10.2021 edhe strategjia për arsimin 2021 - 2026 dhe plani i saj i veprimit 2021 – 2023, e cila parashikon objektiva dhe detyra për qeverinë në fushën e arsimit.⁶



⁵ <https://www.reporter.al/miratohet-me-votat-e-shumices-buxheti-2022-dhe-paketa-fiskale/>

⁶ <https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/>

1.1 KAMPUSET UNIVERSITARE



Një ndër premtimet kryesore të fushatës zgjedhore për arsimin ishte investimi në infrastrukturën arsimore si ndërtimi i kampusit 28000 m² në Qytetin Studenti, kampusit të arteve dhe kampusit të UPT. Megjithëse ndërtimi i kampusit universitar është premtuar prej vitit 2019, ende nuk kemi numër të shtuar të shtretërve, bibliotekave apo shërbimeve të ofruara për studentët në Qytetin Studenti. Më 19 qershor 2019

kryeministri Rama së bashku me kryetarin e Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj deklaruan se do fillonin punimet për ndërtimin e Kampusit Universitar.⁷ Por megjithëse kanë kaluar dy vite e gjysëm nga ky zotim i qeverisë dhe pushtetit lokal ndërtimi i kampusit, sipas edhe një korrespondence të Faktoje më bashkinë Tiranë gjatë vitit 2021 është ende në faze tenderimi dhe gjenerimi fondesh për ndërtimin e objektit.⁸




Ndërkohë Rezidenca universitare studentore nr. 2 që ka në administrim 8 godinat e mjekësisë dhe inxhinierisë për vitin akademik 2021 – 2022 ka në dispozicion të studentëve vetëm 50% të kapacitetit të saj, pra 930 shtretër në total. Katër godinat e tjera, sipas drejtorisë janë në rikonstruksion për shkak të tërmetit të 26 nëntorit 2019, pavarësisht se përfaqësuesit e qeverisë u shprehën se kampuset do të ndërtohen brenda vitit 2020.

Ndërkohë Qyteti Studenti, që është njësia më e madhe akomoduese në Tiranë për vitin akademik 2021 – 2022 strehon 4619 studentë, numër i njëjtë shtretërisht me atë të vitit 2020 – 2021. Pra nuk kemi asnjë shtim të numrit të shtretërve, por vetëm disa punime restauruese në 2 godina. Ndërkohë që

⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=PJdMOzHCxWw>

⁸ <https://faktoje.al/kampusi-i-premtuar-universitar-ende-ne-leter/>

konviktet e Universitetit Bujqësor të Tiranës janë rrëzuar në tokë për t'ju nënshtruar procesit të rindërtimit. Sipas premtimit të qeverisë, konviktet e reja të UBT do të strehojnë vetëm 2100 studentë, pra vetëm 1/3 e numrit total të studentëve që ka ky universitet. Aktualisht në kryeqytet studiojnë rreth 56 500 studentë në universitetet publike dhe rreth 22 000 në ato private, ndërkohë që numri total i shtretërve të vëna në dispozicion nga konviktet është 5549 shtretër, pra konviktet në kryeqytet ofrojnë vetëm 7% kapacitetet akomoduese për studentët e universiteteve.⁹



Në vitin 2018 nëpërmjet Paktit për Universitetin u premtuan ndërhyrje dhe ndërtim të godinave multifunkionale, të cilat brenda tre vitesh do të dyfishonin numrin e studentëve të akomoduar në konvikte nga 7200 në 14 000 studentë. Sot, pas 4 vitesh nga ky zotim, përveç restaurimit të 2-3 godinave në Qytetin Studenti numri i shtretërve në dispozicion të studentëve është 5549 në kryeqytet dhe 2200 në kampusin e ri të UBT, pra ende shume larg objektivit të premtuar në 14 000 shtretër, ndërkohë kujtojmë se Kampusi i Arteve dhe ai i Universitetit Politeknik të Tiranës nuk janë ndërtuar. Universiteti i dytë më i madh në vend, ai i Durrësit me rreth 20 000 studentë nuk ka ende një konvikt publik për studentët e këtij universiteti.

⁹ <https://www.monitor.al/bie-me-5-numri-i-studenteve-ne-2021-universitetet-ge-humben-studente-dhe-ato-ge-fituan/>

Nga ana tjetër kushtet brenda godinave në Qytetin Studenti vijnë të mbeten shqetësuese, duke mbartur gjithë problematikën 30 vjecare të mungesës së higjienës, komoditetit dhe amortizimit. Era Murati, studente dhe banore në godinën nr.3 në Q.S shprehet për Euronews Albania se “Dushet i kemi në katin e parë, 3-4 dushe për rreth 100 vajza. Plus janë me orare dhe dyert nuk mbyllen. Je gjatë gjithë kohës me frikë se mos hyn dikush tjetër. Edhe në banjë dyert nuk mbyllen, nuk kanë asnjë funksion, as lavamanë, është vetëm një që shërben për mbushjen e disa fuçive”.¹⁰



Pamje nga godina nr.3 në Qytetin Studenti, marrë nga Euronews Albania 6/2022

¹⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=BQTOChIMRys>

1.2 UNIVERSITETET



Pas një mungese të gjatë të një strategjie kombetare për arsimin, qeveria shqiptare hartoi një strategji e cila ju nënshtrua edhe konsultimit publik. Pavarësisht rezervave për këtë proces, dokumenti i strategjisë është një udhërrëfyes i mirë për politikën arsimore. **Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021 - 2026** u finalizua në datën 29 tetor 2021, pra viti i parë ku duhej të buxhetohej dhe zbatohet kjo strategji, u kalua me procedura dhe vonesa burokratike.¹¹

Dokumenti përcakton katër objektiva kryesore:

- Së pari është që të sigurohet përfshirja e plotë në klasën përgatitore dhe në arsimin e detyrueshëm, si dhe të rritet aksesin në arsimin parashkollor dhe të mesëm të lartë, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe mjediseve shkollore miqësore.
- Së dyti krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon ata të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie.
- Së treti zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë.
- Së katërti zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të mësuarit.

Bazuar në vlerësimin e ekspertëve të ekonomisë dhe revistës “Monitor”, kostoja totale për zbatimin e Strategjisë është 51.54 miliardë lekë, ku 70.3% e parave janë parashikuar për Arsimin Parauniversitar, 29.7% për Arsimin e Lartë.¹²

¹¹ http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim-621_date-22.10.2021_Per-miratimin-e-SKA-2021-2026.pdf

¹² <https://www.monitor.al/strategjia-5-vjecare-e-arsimit-do-ti-kushtojte-qeverise-415-milione-euro/>

Ndërkombëtarizimi i universiteteve ishte në fokus të diskursit publik për arsimin qeveria pati si zotim të ri në këtë mandate të tretë. Megjithëse konkretisht nuk është hedhur ndonjë hap real drejt këtij objekti, Kryeministri dhe Ministria e Arsimit e kanë përmendur ndërkombëtarizimin e universiteteve në disa takime me Rektorët, Bordin e Akreditimit dhe panelet studentore.¹³

Në fushatën e zgjedhjeve të 25 prillit Kryeministri Rama u shpreh se dallëndyshja e parë e këtij procesi do të jetë binjakëzimi i programeve me Universitetin Teknik të Stambollit.¹⁴ Pas një viti nga mandati i tretë Qëndresa Qytetare pyeti Minsitrinë e Arsimit mbi këtë proces e cila shprehet se marrdhënia mes UTS dhe arsimit shqiptar qëndron vetëm në faktin e shpalljes së bursave për shqiptarët nga ky universitet dhe jo krijimin e programeve apo binjakëzimeve. Pas një verifikimi në ëbsite-n e këtij universiteti, nuk vihen re shpallje për bursa për studentë shqiptarë.¹⁵

Qeveria shqiptare në janar të vitit 2022 shkriu fondin e ekselencës, një instrument ky i instaluar prej 15 vjetësh, i cili i jepte mundësi financiare studeteve ekselentë të studionin në universitetet më të mira në botë me të detyrimin për tu kthyer e kontribuar në Shqipëri.¹⁶ Mbyllja e këtij fondi pati si justifikim mos-kthimin e studentëve që mëbshteteshin dhe ky financim kaloi nëpërmjet një akti tjetër qeveritar tek studentët shqiptar për degët e



¹³ <https://shqiptarja.com/lajm/rama-mbledh-rektoret-ne-universitetin-aleksander-moisiu-ne-durres-ne-fokus-nderkombetarizimi-i-universiteteve-dhe-buxheti-per-arsimin-e-larte>

¹⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=7JXXTrFQ-RY>

¹⁵ <https://www.itu.edu.tr/en>

¹⁶ <https://www.vizionplus.tv/qeveria-heq-fondin-per-ekselentet-rama-vendimi-per-ti-mbajtur-te-rinjte-ne-shqiperi/>

brendshme prioritare në muajin maj, ku do të mbështeten disa student që do të ndjekin degë prioritare me bursa në vlerën e pagës minimale.

Të gjitha ata që tre vitet e studimit i mbarojnë me notën mesatare 10 dhe provimet e maturës me mbi 9.5, e përfitojnë bursën dhe përjashtimin nga tarifat, edhe pse zgjedhin çdo lloj dege që preferojnë. Kategoria e dytë e maurantëve që përfitojnë, janë ata me mesatare minimumi 8.5 dhe zgjedhin një nga programet prioritare. Një tjetër kategori përfituese janë maurantët që kanë zënë një nga 3 vendet e para në olimpiada ndërkombëtare, në të cilat ka të paktën 15 vende pjesëmarrëse. Programi që ata zgjedhin lidhet me fushën ku ka marrë çmim.

Degët prioritare nuk u përcaktuan nga ndonjë studim i tregut të punës, studentët përftues prej vitit 2022 – 2023 nuk do të kenë as vende pune të siguruara në administratë apo biznese private dhe për rrjedhojë rrezikohet që ky investim të shkojë sërish për të rinj që largohen nga vendi.¹⁷

Rankimet ndërkombëtare të cilat u bënë publike gjatë këtij viti i pozicionojnë universitetet shqiptare në nivelin më të ulët në Rajon sa i takon digjitalizimit dhe cilësisë.

Webometric është një matës ndërkombëtar i përmendur edhe si indikator në strategjinë për arsimin 2021 – 2026 ku Universiteti i Tiranës u rendit i **3.786-i**, sipas sistemit matës që përqendrohet në dukshmërinë, aksesin dhe praninë e universiteteve në faqet e tyre zyrtare web.

Universitetet e Rajonit qëndronin shumë larg nga universitetet shqiptare në këtë rankim, në krye qëndron Universiteti Teknik

Kombëtar i Athinës, i renditur në vendin e 384 në klasifikimin global. Pas tij vjen Universiteti i Beogradit i renditur i 447-i, ndjekur nga Universiteti i Zagrebit në Kroaci në vendin e 571, ai i Sofjes në Bullgari në vendin e 988, ndërsa Universiteti i Podgoricës në Malit të Zi renditet në vendin e 1.939.¹⁸

RANKING WEB OF UNIVERSITIES

Repositories Hospitals Business Schools Research Centers

SEARCH

HOME NORTH AMERICA LATIN AMERICA EUROPE ASIA AFRICA ARAB WORLD OCEANIA RANKING BY AREAS

Home » Albania

About Us

- About Us
- Contact Us

About the Ranking

- Methodology
- Objectives
- FAQs
- Notes
- Previous editions

Resources

- Best Practices
- Links

MAVR

www.mavr.net

MAJESTICSEO

ahrefs

SCIMAGO

Albania

Ranking	World Rank	University	Det.	Presence Rank	Impact Rank	Citiness Rank	Excellence Rank
1	6197	University of Tirana / Universiteti i Tiranës	👉	6366	10298	6348	3963
2	6345	Ecoha University / Universiteti Ecoha	👉	2393	9737	7795	4568
3	7464	Polytechnic University of Tirana / Universiteti Politeknik i Tiranës	👉	14115	11637	11513	3568
4	10988	Agricultural University of Tirana / Universiteti Bujëor i Tiranës	👉	17668	13375	14502	4119
5	11052	Universiteti Bedër / SH.LUP Hëna e plotë BEDIËR	👉	6427	12363	8219	5489
6	12297	Professional Business Academy / Akademia Profesionale e Biznesit	👉	17926	7952	20123	5489
7	12541	University Luçë Guratoni Shisoder / Universiteti Luçë Guratoni	👉	11918	13586	6212	5489
8	12563	University of New York Tirana / Universiteti New York në Tiranë	👉	14417	12257	10184	5489
9	12729	University Erenm Cabel Giratolaster / Universiteti Erenm Cabel	👉	16643	16246	15410	3838
10	12865	University of Vlorë / Universiteti Ismail Qemali	👉	15127	12668	9731	5489
11	13254	University Aleksander Moisiu Durres / Universiteti Aleksander Moisiu Durres	👉	15383	13853	6655	5489
12	14139	University Marin Barleti / Universiteti Marin Barleti	👉	13734	14656	10654	5489
13	14385	University Aleksander Xhuvani Elbasan / Universiteti Aleksander Xhuvani Elbasan	👉	13487	14600	12585	5489

¹⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/miratohet-vendimi-per-maurantet-qe-perfitojne-burse-dhe-heqje-tarife-ministrja-per-ata-qe-zgjedhin-deget-prioritare-te-vendosura-nga-qeveria-mesatarja-mbi-85>

¹⁸ <https://www.webometrics.info/en/Europe/Albania>

1.3 SHKOLLAT

Gjatë vitit të parë të qeverisjes situata në shkollat publike ka qënë e trazuar, me peticione nga prindër që kërkonin orar të plotë, konflikte të mësuesve në shkolla, ankesa dhe debate për kushtet dhe kapacitetet. Pas gjithë situatave të keqmenaxhimit të shprehura shpesh herë edhe në media Qëndresa Qytetare kërkoi informacion lidhur me formimin profesional të drejtorëve të shkollave pranë Shkollës së Drejtorëve.

Sipas përgjigjes zyrtare nga viti 2019 deri në dhjetor 2021 kanë realizuar provimin 243 drejtorë shkollash, ku 68 prej të cilëve kanë rezultuar ngelës në provim, por vijojnë të qëndrojnë në pozicionin e drejtorit të shkollës. Një tjetër premtime i Partisë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit ishte pajisja e drejtorëve të shkollave me aftësi për të drejtuar shkollat si qendra komunitare, por nga komunikimi me Shkollën e Drejtorëve rezultoi se certifikata e lëshuar nga kjo shkollë për drejtimin e institucioneve të arsimit parauniversitar pa diferencuar llojin e shkollës, pra nëse do të drejtojë një shkollë qendër komunitare apo jo.

Nga ana buxhetore vumë re një rritje me 21 milion euro në total të buxhetit për shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm, por pritet të shihet nëse këto para do të digjitalizojnë realisht shkollën shqiptare, do të rrisin aftësitë digjitale sic u premtua në fushatën e 25 prillit apo do të kenë fatin e klasave digjitale të premtuara në vitin 2013 dhe të porealizuara në mandatin e parë qeverisës.

Një tjetër problem që ka qënë prezent në shkollat shqiptare prej vitesh, ka qënë mungesa e psikologëve të cilën Qëndresa e adresoi në axhendën e saj për arsim cilësor drejtuar partive politike në fushatë. Një nga sugjerimet e axhendës ishte shtimi i numrit të psikologëve në shkolla, nga 1 psikolog në 3 shkolla në të paktën 1 psikolog për shkollë. Në atë kohë për këtë rekomandim Partia Socialiste nuk shprehu interes në muajin prill, por Ministria Evis Kushi në datën 29 tetor nxorri urdhrin për ristrukturimin e psikologëve në shkolla duke dyfishuar numrin e tyre, si rezultat edhe i ngjarjeve tragjike të njëpasnjëshme të ndodhura në shkollat e vendit.¹⁹

Gjatë planifikimit dhe miratimit të buxhetit 2022, qeveria parashikoi rritjen e pagave të mësuesve me 6%. Premtimi zgjedhor për pagat e mësuesve brenda mandatit të parë ishte rritja në masën 40%, por në 100 ditët e para të

¹⁹ <http://ata.gov.al/2020/10/29/sherbimi-psiko-social-ministrja-kushi-dyfishimi-i-numrit-te-punonjesve-vjen-si-pergjigje-e-nevojave-ne-shkollat-tona/>

qeverisjes u arrit të paktën të planifikohet një rritje me 6% për vitin e ardhshëm, ashtu sic ndodhi edhe me mjekët dhe infermierët.

Ndër premtimet e tjera infrastrukturore gjatë fushatës së zgjedhjeve të 25 prillit ishin edhe hapja e programit 10 vjecar të kodimit në botën digjitale në 12 qarqe dhe hapja e programit të arteve dhe zejeve ku të rritet të mësojnë profesionet e tyre. Për ecurinë mbi këto dy programe Qëndresa Qytetare iu drejtua me kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Nr. 3366/Prot. Tiranë, më 6.6.2022

Lënda: Kthim përgjigje.

QËNDRESA QYTETARE
Ruga "Hoxha Tahsin", Pall. "Vjetro", Ap. 23 A,
Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj me lëndë: "Kërkesë për informacion", regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), me nr. 3366 prot., datë 12.05.2022, për vënien në dispozicion të informacionit, ju informojmë se, për vitin shkollor 2021-2022, në sistemin arsimor të Republikës së Shqipërisë:

1. Gjithsej janë 100 institucione arsimore parauniversitare (IAP) me dy turne, 2 prej të cilave janë të arsimit të mesëm të lartë, ndërsa IAP me tre turne nuk ka.
2. Gjithsej janë 2558 klasa kolektive.
3. Gjithsej janë 1664 IAP, të cilat zhvillojnë lëndën e gjuhës angleze në klasën e parë të arsimit bazë.
4. Lidhur me qendrat e kodimit digjital MAS nuk disponon informacion.
5. Programi i Arteve dhe Zejeve do të fillojë implementimin gjatë vitit shkollor 2022-2023.
6. Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit midis MAS dhe Universitetit Teknik të Stambollit (UTS), marrëdhënia mes UTS dhe arsimit shqiptarë lidhet me ofrimin e bursave nga UTS për nxënësit shqiptarë, në ciklin e parë të studimeve bachelor. Universiteti për çdo vit shpall thirrjen për aplikime në muajin korrik.

Në përgjigjen e datës 6 qershor 2022, Ministria e Arsimit shprehet se nuk disponon **asnjë informacion lidhur me qendrat e kodimit digjital**, ndërsa programi i arteve dhe zejeve pritet të fillojë vitin e ardhshëm akademik. Pra këto dy premtime në 1 vit qeverisje nuk arritën të merrnin jete, zbatim apo financim.

Premtimi tjetër i Kryeminsitrit në fushatën e zgjedhjeve të 25 Prillit

ishte se asnjë shkollë në Republikën e Shqipërisë nuk do të zhvillojë mësim me turne. Por edhe pse ky ishte një premtim i ripërsëritur nga 2013 dhe 2017, sipas informacionit të marrë nga Ministria e Arsimit në qershor 2022 në Republikën e Shqipërisë **100 shkolla zhvillojnë mësimin me turne**.

Ndërkohë një problem tjetër i kahershëm sa i takon cilësisë në arsimin parauniversitar i cili prek krejtësisht nxënësit që jetojnë në zona rurale, fenomeni i klasave kolektive, për të cilin Kryeminsitri Rama premtoi se klasat kolektive do të mbylleshin gjatë mandatit të tretë duke përdorur modelin e arsimit digjital.

Megjithatë tashmë ka kaluar 1 vit nga bërja e këtij premtimi, numri i klasave kolektive në Republikën e Shqipërisë nuk ka ndryshuar, pra numri i tyre është 2558 klasa kolektive, sipas Minsitrisë së Arsimit dhe Sportit. Madje nëse i referohemi edhe Strategjisë së Arsimit 2021 – 2026 thkesohet se aktualisht gjendja e infrastrukturës digjitale le për të dëshiruar, ku raporti kompjuter – nxënës është 1 kompjuter për 27 nxënës, cka nënkupton se digjitalizimi nuk duket forma më e shpejtë dhe efektive për mbylljen e klasave kolektive, por zhvillimi i qëndrueshëm me bazë Rajonet dhe zonat rurale do të ishte një mekanizëm që mund të reduktonte këtë fenomen.

2 KATËR VITE NGA PAKTI PËR UNIVERSITETIN

Ndërkohë Pakti për Universitetin edhe pse një dokument politikash i miratuar në mandatin e dytë të qeverisë Rama me afat të përcaktuar brenda atij mandati, vijon të përmendet nga anëtarët e kabinetit si një sipërmarrje që vijon të shtrijë efektet.


Pavarësisht se disa nga objektivat e paktit vijojnë të shërbejnë ekonomikisht studentëve, sic janë tarifatat e reduktuara, zgjerimi i subjekteve përfituese të bursave apo kantieret e nisura në konvikte, dhet të rikujtojmë se edhe gjatë mandatit të tretë, nisur edhe nga premtimet e partisë socialiste, qeveria nuk ka ndërmend të ndërhyjë në objektivat e lidhura me:

- **Vetëingun e akademikëve**
- **Vlerësimin e pedagogëve nga studentët**
- **Transparencën dhe korrupsionin në nivel universiteti**
- **Rritjen e peshës së votës studentore**

2.1 PORTALI I TRANSPARENCES

Në përgjigje të një ndër kërkesave kryesore të protestës së studentëve në dhjetor 2018, qeveria nxori **VKM nr. 781** për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht ekzistencës së ligjit për të drejtën e informimit dhe detyrimeve që ai parashikon për çdo autoritet publik.

Nga verifikimet e kryera nga ekipi i Qëndresës Qytetare ky portal nuk përmbante të dhëna mbi shpenzimet në nivel universiteti apo rektorati por vetëm të dhëna në nivel fakulteti, gjë që u vështirësonte studentëve të kuptonin shpenzimet totale të universitetit dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.



Një tjetër mangësi e këtij portali janë prokurimet publike, ku për vitin 2020 - 2021 **nuk kemi të publikuar asnjë kontratë** të lidhur nga asnjë universitet, ndërkohë që nga monitorimi ynë rezultojnë dhjetëra kontrata të lidhura nga universitetet me operatorë privatë të tretë nëpërmjet procedurave të tenderimit.

Ndërsa sa i përket vendimeve të organeve administrative dhe akademike, janë publikuar vetëm ato vendime që kanë lidhje me bursat dhe tarifat, por jo vendime me efekt financiar dhe legjislativ brenda universitetit.

Njëkohësisht ky portal duhet të përmbante të gjitha CV-të e pedagogëve të universiteteve sipas VKM, brenda muajit Shkurt, por ende shohim që ka shumë mangësi në këtë drejtim dhe pothuajse i gjithë materiali ka mangësi informacioni.

Në pikën “gj” të këtij vendimi parashikohet se brenda portalit u transparenca.al do të gjenden edhe rezultatet e verifikimit të titujve akademikë, por kjo kategori nuk është parashikuar dhe **nuk ekziston në portal**.

Ndërkohë universitetet vijojnë me shpërdorimin e fondeve njëloj si përpara vitit 2018. Gjatë vitit akademik 2020 – 2021 vetëm UPT përveç pagave bazë ka shpenzuar 357 750 Euro për shpërblime, 101 900 Euro për dieta, 50 500 Euro për karburant makine, 28 000 Euro për telefon/internet dhe 290 000 Euro pagesa të Bordit dhe Senatit Akademik. Vijon të kemi një keqpërdorim të fondeve nga universitetet publike, ashtu si në vitet para protestës studentore.

2.2 VETINGU AKADEMIK


Gjatë protestës studentore në dhjetor 2018, një nga 8 kërkesat e studentëve ishte edhe “Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore”, kërkesë e cila lidhej drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies dhe nivelit të stafit akademik.

Në 26 dhjetor 2019 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 777 “Për kontrollin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, e cila ngarkonte Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me përgjegjësinë e krijimit të arkivit digjital të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradave shkencore në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik si dhe kryerjen e kontrollit digjital antiplagjiaturë të disertacioneve, parashikim që solli reagime të shumta për cenim të autonomies së IAL-ve. Madje, kjo VKM e ngarkoi këtë ministri me sigurimin e softëar-ëve për kontroll automatik si dhe programe apo pajisje të tjera që i shërbenin këtij qëllimi.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bleu soft-in “Platforma Akademia”, një sistem antiplagjiaturë në vlerën 20 mijë euro të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Më 14 janar 2020 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nëpërmjet Urdhërit nr.8 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, urdhëroi që universitetet, para procesit zgjedhor, nëpërmjet këshillave të etikës të verifikonin ligjshmërinë e fitimit të titujve akademikë për kandidatët, duke përfshirë edhe kontrollin anti-plagjiaturë.

Ky veprim, së pari ktheu në pikën zero premtimin dhe iniciativën e ndërmarrë në kuadër të paktit për universitetin, së dyti, pati raste që instrumenti u keqpërdor për të eliminuar kandidatët që mund të rivalizonin rektorët dhe dekanët aktualë apo edhe për të penguar denoncime përmes aspekteve burokratike procedurale. Mungesa e instrumenteve të qartë administrativë për kontrollin e ushtrimit të këtij mekanizmi, apo edhe e rregullimeve të lehtësuara procedurale për raportimin e rasteve të plagjiaturave, bënë që ky mekanizëm të mos ushtrohet ende aktivisht nga ana e IALve.



Universitetet publike, të dakordësuara në heshtje, sollën një instrument të ri, si risi në rregulloret e tyre për organizimin e zgjedhjeve, të paparashikuar në VKM nr. 777, apo në Urdhrin e janarit 2020 të Ministres së Arsimit, i cili u quajt “Formulari i Vetëdeklarimit AntiPlagjiaturë”.

Universitetet publike parashikuan në unison në Rregulloret e tyre të zgjedhjeve se çdo kandidat për organet drejtuese duhet të ketë plotësuar këtë formular, duke anashkaluar kontrollin anti-plagjiaturë dhe verifikimin e titujve akademikë si hallka të rëndësishme për integritetin akademik të pedagogëve dhe drejtuesve.

Gjithashtu, me ndryshimin që iu bë VKM-së nr.777 të vitit 2019, me VKM 99, datë 5.2.2020, tashmë parashikohet se janë vetë IAL-të që kryejnë kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vitin akademik 2021 – 2022, në krye të Minsitrisë së Arsimit u vendos Evis Kushi, periudhë në të cilën Minsitria e Arsimit shkëputi marrdhënien kontraktore me Platformën “Akademia”, e cila zotëronte softin anti – plagjiaturë duke zhbërë tërësisht vendimin e Këshillit të Minsitrave nr 777/2018 dhe duke lejuar

cdo plagjiator të qëndrojnë I qetë brenda sistemit arsimor, ashtu si edhe para protestës studentore të dhjetorit 2018.

Si rezultat i këtij procesi nuk pati asnjë titullar universiteti, asnjë pedagog të cilit iu kontrollua titulli akademik apo grada shkencor, asnjë vendim nga Këshillat e Etikës në universitete për masa të amrra në kuadër të plagjiaturës dhe për rrjedhojë nuk u krijua as arkivi digjital i disertacioneve .

2.3 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTEVE

Protesta e studentëve dhe monitorimet e Qëndresës Qytetare gjatë vitit 2018 ekspozuan nivelin e lartë të perceptimit të korrupsionit në universitetet publike dhe problematika të tjera të stafit akademik si performance jocalësore, kualifikimet fiktive, rekrutimet pa meritë të stafit akademik, kurrikula jo bashkëkohore dhe vlerësime fiktive të performancës nga vetë universitetet.

Pakti për Universitetin e adresoi këtë problematikë duke parashikuar aplikimin e instrumentit të kontrollit dhe vlerësimit studentor të performancës së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të personelit akademik përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Raportet e vlerësimit të përgatitura nga ASCAL do t'i paraqiten Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, krahas Institucionit të Arsimit të Lartë që i është nënshtruar procesit të vlerësimit, si dhe duhet të jenë pjesë e dosjes personale të çdo anëtarit të personelit akademik.



66% E STUDENTËVE SHPREHEN SE PERSONELI AKADEMIK ËSHTË KOMPETENT NË SHPJEGIMIN E NJOHURIVE

Në vitin 2019 pyetësi u plotësua nga rreth 14 000 studentë të IAL-ve publike dhe private përkthyes procesi i anashkaloi dy zotimet kryesore që synonte të adresonte ndaj studentëve që ishin trajtimi i fenomenit të korrupsionit në universitete dhe krijimi i dosjeve të pedagogëve sipas vlerësimit në këtë sondazh. Pavarësisht se rezultatet e plota të Sondazhit nuk janë bërë ende publike, studentët në pyetësor nuk kanë pasur mundësi të shprehen në asnjë pyetje për raste individuale të korrupsionit pasiv, të mungesës së etikës në mësimdhënie dhe të vlerësojnë pedagogët në mënyrë që në bazë të rezultateve të krijohen dosjet e tyre personale.

Nga disa të dhëna të pakta të publikuara nga Minsitrija e Arsimit, Besa Shahini, vihet re se sipas studentëve të

shprehur, 33% e pedagogëve janë inkopetentë në lëndët ku japin mësim, një shifër e lartë në raport më numrin total të pedagogëve.

Gjatë muajit Prill – Muaj 2022, ASCAL tentoi të përsërisë SKS por vëmendja publike, besimi i studentëve dhe pritshmëritë ranë, pasi sondazhi i vitit 2019 nuk preku korrupsionin si element, nuk krijoi dosje personale, nuk u bënë publike rezultatet dhe mbi të gjitha nuk u mor asnjë amsë për 33% të pedagogëve të cilët rezultuan inkopetentë në lëndët e tyre.

2.4 PUNETEMBARE.AL

Në kuadër të paktit për Universitetin u premtuan 1000 vende punë në administratën publike për studentët nëpërmjet një procedure "sui generis" duke plotësuar të gjitha pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive me studentë ekselentë. Kjo mundësi u krijua nëpërmjet VKM nr. 766, datë 26.12.2018 e cila parashikon që për vitin 2019, pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlefshme), në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, të plotësohen me prioritet nga studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 e në vijim, nëpërmjet punësimit të tyre me kontratë të përkohshme 1-vjeçare (njëvjeçare).

Fajda nuk u gjet

Ju kërkohet ndjesë, fajda që ju po kërkoni nuk ekziston. [Kthehu tek fajda kryesore.](#)

Sipas monitorimit të Qëndresës Qytetare ky është një ndër premtimet e mbajtura të qeverisë në kuadër të Paktit për Universitetin por gjithashtu duhet theksuar se premtimet plus nuk erdhën si pasojë e kërkesave të studentëve por si reflektim i vetë ekzekutivit. VKM 766 parashikon se kjo politikë qeveritare është e vlefshme vetëm për vitin 2019 dhe për studentët e punësuar dhe nuk siguron qëndrueshmëri në shërbimin civil por

vetëm eksperiencë pune.

Në datën 30/08/2019 doli VKM nr. 586 e cila synonte të vijonte me tej me punësimin e studentëve të ekselencës në administratën publike, por kjo praktikë u reduktua, numri i ekselentëve u zvogëlua dhe sot portal punëtëmbare.al është jo funksional.

2.5 BIBLIOTEKA DIGJITALE

Për shkak të kostos së lartë të çmimeve të librave dhe mungesës së aksesit të studentëve në botime shkencore për realizimin e detyrave të kursit dhe kërkimit shkencor brenda IAL-ve, ndërtimi i një biblioteke online me standarte evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve.

Në muajin Prill 2019 u prezantua nga Kryeministri dhe ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Biblioteka Digjitale si një nga premtimet e "Paktit për Universitetin" që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime shkencore. Sipas

përfaqësuesve të qeverisë kjo bibliotekë krijon akses ndaj kërkuesve shkencorë në 50 mijë revista shkencore, 193 mijë libra akademikë dhe 30 module për të mësuar vetë nëj gjuhë të huaj. Cdo student apo pedagog mund ta aksesojë bibliotekën online përmes një llogarie unike dhe një fjalëkalimi. Pavarësisht numri të lartë të materialeve shkencore që përmban biblioteka online, **studentët nuk arrijnë të gjejnë informacion që përkon me kurrikulat e tyre mësimore dhe nuk aksesojnë asnjë libër, artikull apo material shkencor në gjuhën shqipe.**

Investimi total nga buxheti i shtetit për Bibliotekën Digjitale është **687.825 USD** pa TVSH për periudhën 2019 – 2022.



3 STUDENTËT DHE KRYEQYTETI

Tirana si kryeqyteti i Shqipërisë ka të paktën 906 000 banorë duke përbërë rreth 30% të popullsisë që banon në territorin e Shqipërisë. Si kryeqendër urbane dhe administrative Tirana ka në territorin e saj numrin më të lartë të universiteteve kryesore publike dhe jopublike të vendit duke akomoduar një numër të lartë studentësh, ku sipas INSTAT aktualisht universitet aksesohen nga të paktën 75 000 studentë nga e gjithë Shqipëria. Ky numër i lartë studentësh, largësia e lagjeve me kosto më të ulët nga qendrat universitare dhe zhvillimi me ritme të shpejta i përball studentët me sfida të ndryshme sociale përtej atyre akademike.

3.1 GJËNDJA EKZISTUESE

Aktualisht studentët për të aksesuar transportin publik përfitojnë abone studenti të cilën e blenë nga Bashkia Tiranë me koston 600 lek/muaj. Bazuar në një komunikim zyrtar mes Qëndresës Qytetare dhe Bashkisë Tiranë, numri i aboneve të studentit që prodhohet për të gjitha linjat është 13 904 copë.



“Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66 datë 30.12.2015 dhe udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr., 3743/2017, studentët përfitojnë abone për të gjitha linjat ndërqytetase me çmim 600 lek dhe bashkia Tiranë është e detyruar ti garantojë çdo individ që gëzon statusin e studentit këtë të drejtë.”²⁰



Por gjatë gjithë kësaj periudhe 8 vjecare numri i aboneve të studentit ka qënë më i ulët se këkesa e studentëve për abone, e për rrjedhojë çdo fund-muaj ka shkaktuar kaos, stres dhe “luftë” mes studentëve se cili do të përfitojë e cili jo abonenë e transportit publik. Ndërkohë që sipas INSTAT në kryeqytet studiojnë 59 765 studentë në universitetet publike dhe rreth 9000 në ato private.

Pra bashkia ofron abone studenti 600 lek vetëm për rreth 20 % të studentëve ndërsa 80 % e tyre duhet ta blenë abonenë e përgjithshme si çdo qytetar me çmimin 1600 lek ose të paguajnë

²⁰ <https://www.cna.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendim-i-Keshillit-Bashkiak-Tirane-nr-66-viti-2015.pdf>

biletën 40 lek për çdo udhëtim, pavarësisht se sipas ligji duhet ta përfitojnë të gjithë këtë abone.

Një tjetër problematikë e hasur ndër vite, por e rregulluar pas vitit 2019 me daljen në qarkullim të Kartës së studentit ka qënë shitja e abonesë së studentit në treg të zi nga punonjësit e operatorëve të transportit publik dhe mungesës së informacionit për një vend të paracaktuar ku studentët mund të pajisen me këtë document. Bashkia Tiranë aktualisht nuk ka asnjë procedurë ligjore të parashikuar mbi mënyrën e pajisjes me abone studenti, por janë vetë operatorët privatë që pajisin studentët me abone në kioskat ku shiten edhe abonete e tjera.

Reagime studentësh në media: *“Dje kisha 4 orë që prisja, sot kam 2 orë, dhe nuk e di nëse do të mund që të arrij orën e leksionit.*

Nga ora 3 e gjysëm deri në 7 kam qëndruar këtu dhe nuk e kam marrë abonenë, pasi na thanë që në atë orë sistemi mbyllej. Është vetëm një vajzë e cila punon në pikën e shitjes”,

3.2 NDIHMA E SHTETIT PËRBALLË SHPENZIMEVE TË STUDENTËVE

Qeveria shqiptare e financon arsimin e lartë më pak se të gjitha qeveritë e Rajonit dhe Bashkimit Europian me vetëm 2.6% të PBB.²¹ Zërin kryesor mbështetës ndaj studentëve e zënë bursat për studentët ekselentë me mesatare nga 9 - 10 dhe kompesim i tarifave të studimit për studentët e bachelor, në kuadër të paktit për universitetin.



Bursa e studentit është në vlerën 10 000 lek të reja, shumë e cila në raport me kostot e një student në kryeqytet është e pamjaftueshme për të mbuluar kostot e larta të jetesës. Përveç kësaj prej vitit 2019 kur janë akorduar bursat, studentët janë ankuar për vonesa të tyre me 3 ose 4 muaj distancë.²²

Citim nga një student: *“Nuk arrij ta kuptoj si mendon qeveria se studentët kanë arritur të mbahen ekonomikisht që nga fillimi i vitit akademik. Jeta studentore ka shpenzime të konsiderueshme, si: ushqimi, strehimi, transporti, apo edhe librat e shkollës. Dhe ndihmesa ekonomike*

²¹ <https://ndiqparate.al/?p=14841>

²² <https://www.youtube.com/watch?v=F-TGdOKhwb0>

familjare shpesh herë nuk mjafton. Qindra studentë presim ende akordimin e këtyre bursave pasi është detyrim i shtetit ndaj nesh”.

Shpenzimet studentore për studentët që vijojnë procesin mësimor në kryeqytet rezulton të jenë studentët me barrën më të lartë financiare për shkak të kostove të larta të jetesës, tregut imobiliar, mungesës së konvikteve dhe mundësive të pakta të mbështetjes studentore.

Akomodimi u zë studentëve që studiojnë në kryeqytet një peshë të lartë në portofolin e tyre mujor duke qënë se përvec tarifës së studimit u duhet të paguajnë ose një tarifë shtesë për akomodimin në konvikt ose të sigurojnë një shtëpi me qera në Tiranë. Aktualisht Rezidencat studentore në Bashkinë Tiranë akomodojnë 7 – 8 % të totalit të studentëve me një numër 5550 shtretërisht nga 70 000 studentë që ndjekin studimet në universitetet publike dhe jopublike.



Sipas sondazhit të realizuar nga Qëndresa Qytetare 57.8% e studentëve pohojnë se paguajnë 50 deri në 150 euro në muaj për qera banese, 18.2% deklarojnë se banojnë në familjen e tyre, ndërsa 24% janë shprehur se shpenzojnë 200 euro ose më shumë për akomodimin në kryeqytet. Mesatarisht një studenti në kryeqytet i duhen minimalisht 324 euro për të përmbushur nevojat bazike të tij, shifër 4 herë më e lartë se bursa që i akodron shteti, ku 23.6% të kësaj shume e zë akomodimi.

Sipas vlerësuesve të pasurive të patundshme vetëm gjatë vitit 2021 -2022 cmimet e apartamenteve dhe qerave janë rritur me 15%. Vlerat e banesave me qera shkojnë nga 200 euro në periferi deri në 800 euro brenda unazës së Tiranës. Ky fenomen i ka detyruar studentët të akomodohen larg qendrave universitare dhe fakulteteve duke kërkuar banesa më të lira me qera në zonën e Freskut, Astirit apo Yzberishit, zona nga të cilat për të mbërritur tek Universiteti i Tiranës apo Politeknik duhet të marrës së paku dy linja autobusi.

Citime nga studentë²³²⁴

“Shtëpia ndodhet relativisht larg, në zonën e Saukut, dhe nuk kemi shumë markete apo farmaci afër. Por nuk na ngeli zgjidhje tjetër. Në fillim ishim 5 djem, tani kemi ngelur 2, pasi të tjerët kanë lëvizur në shtëpi të tjera,”

²³ <https://www.reporter.al/2020/02/21/te-varfer-dhe-te-padeshiruar-studentet-perballen-me-sfiden-e-strehimit-ne-tirane/>

“Të them të drejtën, ne morëm shtëpinë e parë që gjetëm të gatshme, pasi një pjesë e shtëpive që kishim gjetur, sapo e shihnim që ishim vetëm çuna, na e anulonin dhe thonin se shtëpia ishte dhënë.”.



Ushqimi zë peshën kryesore të shpenzimeve të studentëve në kryeqytet, me gati 40% të kostos të jetesës së tyre në kryeqytet, ndërsa literatura, rrobat dhe argëtimi zënë 28%.

Mungesa e një mence publike, rritja e çmimeve të ushqimeve e për pasojë edhe e restoranteve dhe mungesa e uljeve që parashikon Karta e Studentit për sa i përket ushqimeve dhe restoranteve i ngarkon studentëve barrën më të lartë të kostove në të ushqyerit e tyre.

Pronarja e një prej menceve private në Qytetin Studenti shprehet:

“Ne nuk ofrojmë ulje për studentët, madje nuk jam e informuar fare për këtë pjesë, këtu të gjitha mensat janë private”.

Transporti urban iu kushton studentëve 8.2% të kostos së tyre mujore ose mesatarisht 20 – 30 euro, për studentët që nuk përfitojnë dot abone studenti.

Nivel i varfërisë dhe të rinjtë: Në Shqipëri, rreth 40% e popullatës jeton me 5.5 \$ në ditë dhe krahasuar me vendet e tjera në rajon si Serbia, Maqedonia, BosnjaHercegovina, Mali i Zi, Kosova, ky është niveli më i lartë i shtrirjes së varfërisë (Ëorld Development Indicators, 2018) Grupet që janë më të disavantazuara dhe jetojnë në varfëri janë: i) të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, (Ëorld Development Indicators, 2018) fëmijët, sipas raportit të UNICEF për mirëqënien e fëmijëve, 19.2% e familjeve me fëmijë jetojnë në varfëri absolute (UNICEF, 2016).

Këto tregues përforcojnë nevojën që kanë studentët për mbështetje dhe ndihmë shtetërore gjatë periudhës së tyre të studimit.

3.4 KARTA E STUDENTIT SI MUNDËSI PËR TRANSPORT PUBLIK FALAS

Karta e Studentit prej 3 vitesh është dokument me të cilin janë pajisur pothuajse të gjithë studentët e Universiteteve publike dhe jo publike të Tiranës. Pavarësisht se ligji 80/2015 ia njeh të drejtën për ta prodhuar dhe buxhetuar Minsitrisë së Arsimit, qeveria nëpërmjet VKM nr.266/2019 ja kaloi të drejtën edhe njësive të vetqeverisjes vendore për ta prodhuar dhe administruar kartën e studentit me fondet e tyre.



Prej 4 vitesh Bashkia Tiranë dhe Shteti nuk ka injektuar ndonjë fond për të mbështetur shërbime dhe produkte me cmime të reduktuara për studentët duke i ribursuar ato me para publike, por ka shërbyer si mjet me të cilin janë përfituar lehtësira për të cilat vetë bizneset janë ofruar me kërkesë të bashkisë për të bërë ulje ndaj studentëve pa u ribursuar nga shteti, e për rrjedhojë uljet janë minimale, ndërsa për shërbimet publike, uljet nuk implikojnë buxhetin e shtetit apo bashkisë, pasi hyrjet në muze apo kala janë të ralla dhe mund të ndodhin vetëm një herë për cdo student.

Në nenin 100, pika 3 i ligjit për arsimin e lartë shprehimisht thuhet *“Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësive të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.”* pra baza ligjore për të pasur një fond të posacëm nga minsitria ose bashkia është evidente por në këto 4 vite nuk ka ndodhur një praktikë e tillë.

Në rastin e përfitimit të abonesë të transportit publik 600 lek për 13 000 studentët, koston e mbulojnë vetë operatorët e transportit publik, të cilët shpesh shprehin pakënaqësi për këtë kosto të shtuar dhe të pa ribursuar nga Bashkia. Prandaj ka ardhur momenti që Bashkia dhe ministria përgjegjëse për arsimin të alokojë një buxhet vjetor për të mundësuar transportin publik urban qytetas falas për studentët duke ribursuar operatorët e ofrimit të këtij shërbimi dhe duke përdorur kartën e studentit si mjet identifikimi për studentët që udhëtojnë.

Modele ndërkombëtare



Gjermania - Në Gjermani studentët përfitojnë nëpërmjet Kartës së Studentit dhe pagesës që i bëhet universitetit si taksë simestrale, mundësi për studentin për të udhëtuar në transportin publik urban falas.

Holanda dhe Agnia ofrojnë të gjitha format e transportit publik falas për studentët vendas nëpërmjet identifikimit nga Karta e Studentit të cilën e lëshon universiteti.

Turqia dhe Italia - Për të gjithë studentët në


Turqi dhe Itali ofrohet një ulje e konsiderueshme mbi 50% për transportin publik qytetas dhe jashtë qytetës.

Transporti publik falas si nevojë për studentët

Kjo politikë duhet të vijë në këtë moment si plotësim i nevojës që kanë studentët për të reduktuar kostot e tyre mujore ku transporti u zë 8.2% të tyre, si mbështetje nga shteti, në mungesë të mencave publike, pamundësisë për ti akomoduar të gjithë studentët në kampuse dhe mungesës së mbështetjes nga universitetet publike. Në kushtet kur varëfëria është rritur për shkak të rritjes së cmimeve të ushqimeve, kjo politikë vjen si një amortizues dhe lehtësues për barrën financiare që u është shtuar atyre dhe familjeve të tyre. Kjo politikë duhet të vijë edhe si plotësim i nevojës që kanë studentët për të aksesuar Bibliotekën Kombëtare e cila ndodhet 5 deri në 6 kilometër larg lagjeve që banohen me studentë, Teatrit, Kinemasë, muzeve dhe qendrës së qytetit për të integruar studentët në jetën qytetare të vendit.

Transporti publik falas si nxitës i mobilitetit të studentëve


Godinat e Universiteteve dhe fakulteteve në Bashkinë Tiranë janë të pozicionuara në distance të largëta nga njëra tjetra, por edhe nga Qyteti Studenti dhe sidomos nga lagjet e banuara më së shumti me studentë sic janë lagjai e Astirit apo Freskut. Kjo distancë mes fakulteteve ka ulur mobilitetin e studentëve, njohjen mes njëri tjetrit dhe bashkëveprimin e tyre, pasi kostoja e lartë e transportit urban nuk e inkurajon lëvizshmërinë në qytet. Pavarësisht se disa fakultete dhe Universitete kanë lidhje organike dhe profesionale mes tyre, studentët për shkak të distancës rrugore qëndrojnë larg nga bashkëmoshatarët e tyre, të cilët së shpejti do të jenë kolegët e tyre në profesion. Për ta ilustruar po analizojmë tre raporte distance që kanë studentët për të kuptuar se politika e mundësimit të transportit public falas për ta është një politikë nxitëse e mobilitetit të studentëve.



Distanca mes universiteteve dhe midis konvikteve dhe universiteteve në Bashkinë Tiranë

Distanca mes Fakultetit të Gjeologji Minerave dhe dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit është 10 Kilometër ne rrugë automobilistike dhe kërkon 18 minuta kohë për të mbërritur me mjete transporti ndërsa në këmbë kërkon një ecje prej 54 minutash. Një distancë e cila, në kushtet e pagesës së biletës së urbanit kërkon shkëmbimin e dy linjave urbane duke rritur kostot e studenteve dhe e bën të pamundur mobilitetin, shkëmbimin, njohjen e studentëve të cilët studiojnë brenda të njëjtit universitet, pra atij Politeknik.

E njejta situatë paraqitet edhe për studentët që banojnë në Qytetin Studenti dhe studiojnë tek Fakulteti i Shkencave Sociale, ku duhet të përshkojnë një distancë prej 7.3 kilometrash, dhe më këmbë ju duhen 40 minuta për të mbërritur.



Distanca mes lagjeve të banuara nga studentët dhe fakulteteve

Distanca mes Fakultetit të Ekonomisë dhe atij të Filologjisë dhe një prej lagjeve më të preferuara për të jetuar nga studentët për shkak të kostove të qerasë, zonës së Astirit është 9.1 kilometër ose 1 orë e 13 minuta për tu përshkruar në këmbë. Për të aksesuar fakultetin studentëve u duhen minimalisht të ndrojnë dy linja autobuzash.

Edhe distanca prej lagjes tjetër të preferuar prej studentëve, zonës së Freskut është 6.6 kilometër dhe nevojiten dy linja autobuzi për të mbërritur në destinacion. Nëse një student nuk ka arritur të sigurojë abonenë e studentit, vetëm kostoja e transportit shtëpi – universitet i kushton 3800 lekë. Prandaj mundësimi i transportit publik falas për të gjithë studentët duke njehsuar abonenë e studentit dhe Kartën e Studentit do të nxiste mobilitetin e studentëve dhe do të lehtësonte barrën e kostove financiare të tyre në kryeqytet.

Fatura financiare e njësimi të abonesë së studentit me Kartën e Studentit, me qëllim mundësimine transportit urban qytetas falas për të gjithë studentët, nëse do të prezumojmë se bashkia do të paguajë tarifën 600 lek për 70 000 studentë, kjo i kushton Bashkisë Tiranë ose buxhetit të Shtetit rreth 4 milion euro në vit, apo 3.3% e totalit të shumës së arketuar nga taksat e qytetarëve në një vit nga Bashkia Tiranë apo 0.00008% të buxhetit të shtetit shqiptar.

GJETJET KRYESORE



36 muaj pas premtimit publik, qeveria nuk ka nisur ende ndërtimin e kampusit universitar në Qytetin Studenti me godina multifunkionale, menca dhe biblioteka me standarte bashkëkohore.



Ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare ishte një proces që nuk nisi në një vit qeverisje, dallëndyshja e parë e këtij procesi, Universiteti Teknik i Stambollit nuk erdhi në vendin tonë.



Aktualisht në Shqipëri 100 shkolla zhvillojnë mësim me turne dhe nxënësit e 2558 klasave mësojnë në mënyrë kolektive. Duke deshmuar se ne shkollat shqiptare nuk pati rritje të standardeve të mësimdhënies sipas premtimeve të bëra në 25 prill.



Pas 4 vitesh, Pakti për Universitetin përmendet nga politikanët si histori suksesi por referuar zotimeve fillestare sot kemi një portal transparence jo funksional, 0 rezultate nga vetingu akademik dhe 33% të lektorëve inkopetentë për lëndët sipas sondazhit kombëtar të studenteve.



Portali i krijuar për punësimin e studentëve ekselentë në vitin 2019 www.punetembare.al është jashtë funksionit dhe prej vitit 2020 nuk përditësohet më.



Numri i aboneve të studentit ka qënë më i ulët se këkesa e studentëve për abone, e për rrjedhojë çdo fund-muaj ka shkaktuar kaos, stres dhe "luftë" mes studentëve se cili do të përfitojë e cili jo abonenë e transportit publik. Mungesa e abonesë për të gjithë studentët, rrit me 20 deri në 30 euro në muaj kostot e studentëve që nuk përfitojnë abone të transportit publik.



Kredia studentore edhe pse një mekanizëm i parashikaur ën ligjin për arsimin e lartë prej 6 vitesh nuk zbatohet për shkak të mungesës së akteve nënligjore.

REKOMANDIME

Qeveria duhet të rrisë kapacitetet akomoduese në kryeqytet për të mbuluar të paktën 50% e totalit të studentëve që vijnë nga rrethet dhe studiojnë në kryeqytet.

Qeveria duhet të bëjë transparencë ndaj publikut dhe studentëve lidhur me ndërtimin e kampuseve universitare të planifikuara dhe premtuara në fushatën zgjedhore të 25 prillit, përfshi edhe mbështetjen e Bankës Gjermane për Zhvillim (KFË).

Këshilli i Ministrave duhet të miratojë VKM-në për përcaktimin e skemës së Kreditimit Studentor, në zbatim të nenit 114 të ligjit për Arsimin e Lartë, me qëllim mundësimin e kredisë studentore si mjet për të ndihmuar financiarisht studentët.

Fuqizimi, buxhetimi dhe kombëtarizimi i Kartës së Studentit si një mjet që i shërben studentëve për të reduktuar pagesat e shërbimeve, mundësimin e transportit publik falas dhe uljen e çmimeve të produkteve bazë.

Rritja e masës së bursës ndaj studentëve me nevoja të vecanta dhe studentëve ekselentë, në masën e shumës që mundëson një jetesë normale studentore në kryeqytet dhe qytetet universitare.

Zbatimi i zotimeve të ndërmarra në kuadër të Paktit për Universitetin lidhur me cilësinë në arsim si kontrolli anti – plagjiaturë, verifikimi i titujve akademikë, transparencën e IAL-ve dhe vlerësimin real të pedagogëve nga studentët.



QENDRESA
QYTETARE